



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Raporti mujor: Për muajin Shkurt -2016

POZICIONI : Basri Hashani, drejtor i DRSK-së

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1,1 – Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Procedurë	Të Pazgjidhura
12	10	-	2	-

Tabela-1.2 – Pasqyra e lëndëve të pranuar nga palët dhe të shqyrtuara

N r.		SASIA	SHËNIM
1	Këkesë:Youth Center-Sport net	1.760€	Pë realizimin e projektit
2	Mështetje financiare:OJQ Progresi I Ashkalive të Kosovës	500€	Pë realizimin e aktiviteteve të 15 Shkurtit 2016 (Ditës së Flamurit)
3	Kërkesë:OJQ General Youth Edukacion of Kosova	910€	Pë realizimin e projektit
4	Mështetje financiare:AKV "Lipjani"	1.000€	Pë realizimin e aktiviteteve të 17 Shkurtit 2016
5	Mështetje financiare:Emin Grejgevc	1.500€	Shpërblim për zgjedhjen :Sportistë i vitit 2015
6	Mështetje financiare:Erblina Rama	1.500€	Shpërblim për zgjedhjen :Sportiste e vitit 2015
7	Mështetje financiare:OJQ OMPAKL	600€	Për nevojat e OJQ
8	Mështetje financiare:Shoqata e pedagogogve të sporteve Shkollore	800€	Për nevojat e SHPSSH për vitin 2016
9	Mështetje financiare:OJQ "Sveti Sava"	1.000€	Për nevojat e OJQ
10	Mështetje financiare:KH."Ulpiana"	1.000€	Për nevojat e klubit për vitin 2016

Tabela- 2 Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal - Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vrejtje
30	28	74	2	Janë inkasuar 37€

Tabela-3 Raporti për muajin Qershor për Biblotekën e Qytetit dhe Bibliotekat në teren

Libra në huazim dhe të kthyerat	Lexues të rinjë	Përpunimi i librit	Lexus në sallën e leximit
1016	498	47	415

* Kemi punuar raportin për muajin Januar 2016

*Së shpejti do të fillojnë punimet e ndërtimit të Qendrës Rinore në Magurë.

Komuna e Lipjanit, ka filluar procedurat e tenderimit për implementimin e projektit, për ndërtimin e Qendrës Rinore në Magurë.

Marrëveshje e Bashkëpunimit në mes Komunës së Lipjanit dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e nënshkruar ditë më parë nga kryetari i komunës z. Imri Ahmeti dhe ministri z.Kujtim Shala , projekt i cili i do të kushtoj 387, 618.20 euro. MKRS-së do të ndihmoj duke financuar në këtë projekt, me shumë prej 250 mijë euro, ndërsa Komuna e Lipjanit do të vazhdoj me pjesën e mbetur me 137,618.20 euro.

*** Raporti për 17 Shkurtin Ditën e Pavarësisë së Kosovës**

Në kuadër të festës së 8 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Lipjanit z.Imri Ahmeti e të organizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në Kinemanë e qytetit të Lipjanit, është mbajtur një shfaqje teatrale “ Viza” e përgaditur nga Organizata joqeveritare Art Line, në bashkëpunim me nxënësit e Gjimnazit “Ulpiana” në Lipjan.

Në Qendrën Kulturore,“ Tahir Sinani” në Lipjan, është mbajtur koncert festiv për qytetarët e komunës së Lipjanit, ku kanë përformuar këngëtarë nga estrada kosovare si dhe AKV. “Lipjani”, Në këtë eveniment ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti me bashkëpunorë dhe musafir nga Shqipria.

Në Sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, është mbajtur Akademi Solemne, të cilën fillimisht e ka hapur kryesuesja e kuvendit komunal znj. Vlora Limani –Hajnuni.

Me këtë rast, kreu komunal, Imri Ahmeti është shprehur, se sot me 17 shkurt kujtojmë ndjenjat më të veçanta që kemi përjetuar në data historike të shënuara ndër vite.

Sot, festojmë tetë vjetorin e lindjes së shtetit tonë, duke kujtuar të kaluarën tonë të lavdishme.

Pas akademisë solemne, Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë të tij, ka bërë homazhe tek varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Kleçkë, Ribar të Vogël ,Hallaq , Sllavi dhe e Tërbovc.

Në Qendren Arsimore Sportive, është mbajtur turniri në voleyboll (femra), në mes të Klubeve të Voleybollit “ Ulpiana”, K.V. “Drita” e Gjilanit, K.V. “ Kastrioti”, nga Ferizaj dhe K.V. “Skenderaj”.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka përgëzuar ekipin fitues duke i dhuruar kupen K.V , “ Drita” nga Gjilani e cila pas finales me K.V. “Skenderaj”, doli fituese me rezultat 3:0 me seta.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Lipjan, në bashkëpunim me Qendrën Rinore Publike “ Vizion Rinor” i Janjevës si dhe me Kuvendin e të Rinjëve të Lipjanit, në Amfiteatrin e shkollës së mesme “Adem Gllavica” në Lipjan, kanë zhvilluar një debat me të rinjtë e Komunës së Lipjanit

Kryetari Ahmeti, inkurajon të rinjtë lipjanas, që t'i bashkohen zhvillimeve të Komunës së Lipjanit

DRKS- në bashkëpunim me Qendrën Rinore Publike “ Vizioni Rinor” i Janjevës ,kanë organizuar një mbrëmje rinore me të rinjtë lipjanas, ku më pas ju është bashkangjitur edhe Kryetari i Komunës,z. Imri Ahmeti.

* Kemi ba dekorimin e qytetit për 17 Shkurtin, ditën e Pavarsisë së Kosovës

* Takim me OJQ-të dhe Klubet Sportive,

* Me shefin e arkivit jemi dalë në vizitë disa prej shkollave, për të pare për së afërmi, dokumentacionin që ndodhet nëpër Arkivat e shkollave.

* Kemi marrë pjesë në punimet e Komitetit për politikë dhe financa.